

URDHËR
Nr. 375/1, datë 5.9.2012

PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT TË ADMINISTRATORËVE TË CERTIFIKUAR TË FALIMENTIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 282/3 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentin”, të ndryshuar, si dhe pikës 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 852, datë 21.10.2010 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit”,

URDHËROJ:

1. Krijimin e Regjistrit të Administratorëve të Certifikuar të Falimentit.
2. Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit është organi përgjegjës për krijimin dhe administrimin e Regjistrit të Administratorëve të Certifikuar të Falimentit. Në këtë regjistër mbahen të dhënat e Administratorëve të Certifikuar të Falimentit.
3. Regjistri i Administratorëve të Certifikuar të Falimentit mbahet në dy forma:
 1. Në formë manuale (me shkrim);
 2. Në formë elektronike (digjitale).
4. Regjistri manual dhe ai elektronik kanë të njëjtin format standard. Format standard gjendet bashkëlidhur këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij. Elementet e veçanta që karakterizojnë regjistrin elektronik, nuk përbëjnë shmangie nga forma standarde e regjistrit dhe lidhen vetëm me paraqitjen elektronike të të dhënave. Rregullat e plotësimit të regjistrit manual dhe atij elektronik janë të njëjta.
5. Regjistri manual përbëhet nga 100 fletë formati “A3” të lidhura, numëruara dhe të vulosura në çdo faqe me vulën e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit. Çdo administratori të certifikuar të falimentit i përket një faqe në regjistrin manual. Në raste të rralla, kur një faqe nuk është e mjaftueshme për të pasqyruar të dhënat e administratorit të certifikuar të falimentit kalohet në faqen tjetër, duke bërë shënimin përkatës në kolonën “shënime”, të parashikuar në pikën 10 të këtij urdhri.
6. Në pjesën e pasme të faqes së fundit të çdo regjistri manual, punonjësi i strukturës përgjegjëse në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Falimentit, për administrimin e Regjistrit të Administratorëve të Certifikuar të Falimentit, bën shënimin me shkrim dore:

“Ky regjistër përbëhet nga faqe të numëruara e të vulosura, të cilat u kontrolluan dhe u sekretuan sot, më datë (shënohet dita, muaji, viti, emri, mbiemri dhe nënshkrimi i punonjësit).”

Në fund, ky shënim vuloset me vulën e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.
7. Kur një regjistër manual plotësohet, kalohet në regjistrin tjetër duke bërë shënimin në pjesën e pasme të faqes së fundit të regjistrit të plotësuar, si më poshtë:

“Ky regjistër u plotësua sot, më datë (shënohet dita, muaji, viti, emri, mbiemri dhe nënshkrimi i punonjësit).”

Në fund, ky shënim vuloset me vulën e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.
8. Kur hapet një regjistër i ri manual, në shënimin që bëhet në faqen e fundit sikurse parashikohet në pikën 7, shtohen edhe fjalët:

“Ky regjistër është vazhdim i regjistrit të plotësuar më datë (shënohet dita, muaji, viti, emri, mbiemri dhe nënshkrimi i punonjësit).”
9. Në rastin e regjistrit elektronik, kur bëhen gabime në hedhjen e informacionit, rreshti elektronik i shkruar gabim nuk fshihet, por vendoset statusi gabim dhe regjistrohet një rresht i ri me të dhëna të sakta, i cili reflektohet në formatin elektronik të regjistrit.
10. Numri i faqeve të regjistrave manuale është në përputhje me numrin total të administratorëve të certifikuar të falimentit. Në rast se hapen dy ose më shumë regjistra të administratorëve të certifikuar të falimentit, këto regjistra mund të numëtohen në faqen e parë të tyre. Numërtimi bëhet nga punonjësi i strukturës përgjegjëse në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Falimentit për administrimin e Regjistrit të Administratorëve të Certifikuar të Falimentit.
11. Çdo faqe e regjistrave, në krye emërtohet: Regjistri i Administratorëve të Certifikuar të Falimentimit”. Çdo faqe është e përbërë nga dy pjesë, pjesa e parë është e ndarë në 5 rreshta dhe jep të dhëna

të përgjithshme për çdo administrator të certifikuar falimentit. Pjesa e dytë është e ndarë në 30 rreshta dhe në 9 kolona, në të cilën paraqiten të dhëna në lidhje me veprimtarinë e administratorit të certifikuar të falimentit, sipas modelit të paraqitur në shtojcën bashkëlidhur këtij urdhri.

Pjesa e parë përfshin emërtimet e mëposhtme:

1. Emri, atësia dhe mbiemri i administratorit të certifikuar të falimentit;
2. Datëlindja;
3. Vendbanimi;
4. Numrin e licencës;
5. Adresën e vendit ku zhvillohet veprimtaria e administratorëve të certifikuar të falimentimit.

Pjesa e dytë përfshin emërtimet e mëposhtme:

1. Nr. (numri rendor i kërkesës që do të regjistrohet);
2. Data e dhënies së licencës;
3. Statusi i licencës;
4. Data e fillimit të veprimtarisë së administratorëve të certifikuar të falimentimit, në rast statusi aktiv i licencës;

5. Çështjet në të cilat është emëruar si administrator i përkohshëm i falimentit;
6. Afatet e emërimit;
7. Çështjet në të cilat është emëruar si administrator i përhershëm i falimentit;
8. Afatet e emërimit;

9. Shënime (pasqyrohen të dhënat që nuk përfshihen në rubrikat e tjera dhe që çmohen se janë të rëndësishme për t'u pasqyruar, p.sh. kalimi në faqe tjetër, si rast përjashtimor, për efekt plotësimi, pasqyrohet shkurt arsyeja e shënimeve ose e ndryshimeve në të dhënat e regjistrit, si dhe data, muaji, viti, emri, mbiemri e nënshkrimi i personit që ka bërë shënime).

12. Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit është struktura përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e regjistrit të administratorëve të certifikuar të falimentit. Agjencia përditëson të paktën një herë në 3 muaj regjistrin dhe/ose në përfundim të çdo procesi certifikimi, si dhe siguron publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

13. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi